



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

C-II.-13-0146-C0001

Paditësi:

N.I. dhe të tjerët, Prizren

Kundër:

E paditura:

Ndërmarrja Shoqërore, Prizren, e administruar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. “Agim Ramadani”, Nr. 23, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtarja Teuta Ibrahim, më 30 shtator 2019, lëshon këtë:

AKTVENDIM

- 1. Procedura në këtë çështje juridike pezullohet, për arsye se Ndërmarrja Shoqërore , Prizren, është në likuidim.**
- 2. Çdo kërkesë për rihapje të një lënde të pezulluar do të trajtohet si lëndë e re dhe asaj do t'i caktohet numri i ri i lëndës.**
- 3. Lënda në fjalë e pezulluar për shkak të likuidimit të NSH-së konsiderohet lëndë e mbyllur.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Më 6 korrik 1995 paditësi N.I.me të tjerët kanë parashtruar padi në Gjykatën Komunale në Prizren kundër Ndërmarrjes Shoqërore lidhur me anulimin e vendimit përmes së cilit këta paditës ishin larguar nga puna si tepriçë teknologjike.

Nga Gjykata Komunale në Prizren ata kanë kërkuar që të anulohet vendimi i lartpërmendur dhe të obligohet e paditura që t'i kthejë në vendin e tyre të punës.

Më 9 korrik 1996 paditësi N.I. e autorizon avokatin E.H. për ta përfaqësuar në këtë kontest të marrëdhënies së punës.

Provë e bashkëngjitur:

- *autorizimi i avokatit për përfaqësim;*
- *procesverbali nr. 588/95 i datës 10 korrik 1996.*

Më 2 shtator 1996 Gjykata Komunale në Prizren kishte nxjerrë Aktvendimin nr. 588/95 përmes së cilit kishte refuzuar si të pabazuar kërkesën e paditësit N.I. dhe të tjerëve për të ardhurat personale.

Më 30 nëntor 2010 Agjencia Kosovare e Privatizimit nxjerr njoftim ku si pasojë e shitjes së asetëve përfundon punësimi i punëtorëve të NSH-së, pikërisht më datën e këtij njoftimi. Kërkesat e punëtorëve do të shqyrtohen sipas procedurave të likuidimit dhe AKP-ja.

Më 7 mars 2011 Gjykata Komunale në Prizren nxjerr një aktvendim përmes së cilit e detyron të paditurën NTSH nga Prizreni që në afat prej 15 ditëve nga dorëzimi i padisë me të gjitha shkresat të cilat i janë bashkëngjitur këtij aktvendimi t'i paraqesin gjykatës përgjigje në padi në formë të shkruar në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe palën e paditur, nën kërcënimin e pasojave procedurale.

Më 7 prill 2011 e paditura NTSH Prizren, dorëzon përgjigje në padi drejtuar Gjykatës Komunale në Prizren. Në këtë përgjigje e paditura thekson se dokumentacionin e kërkuar nga gjykata e kanë marr ish eprorët e organeve të dhunshme të kësaj ndërmarrjeje. Pas luftës një pjesë e punëtorëve janë kthyer në punë në NSH.

Si provë ka bashkëngjitur: *regjistrin e të ardhurave të punëtorëve që kanë punuar gjer më 30 nëntor 2010.*

Më 3 nëntor 2012 Gjyqtarja e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme i ka dërguar një urdhër paditësve që brenda 15 ditëve nga pranimi i urdhrit të dorëzojë në gjykatë mes tjerash dokumentet vijuese:

- *përktimin në gjuhën angleze të të gjitha dokumenteve të dosjes së Gjykatës Komunale në Prizren C. nr. 588/95;*
- *padinë e korrigjuar dhe të kompletuar drejtuar Dhomës së Posaçme;*
- *përktimin në gjuhën angleze të padisë së re;*
- *dëshminë se AKP-ja është njoftuar para ushtrimit të padisë së re;*
- *listën e provave të paditësit të cilat e ka ndërmend t'i paraqesë dhe përktimin në gjuhën angleze, etj.*

Paditësi ka dorëzuar provat vijuese:

- *Certifikatën e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale nr. 02/94 të datës 04.12.2012, mbi kohën e papunësisë;*
- *Kërkesën për lirim nga pagesa e taksës administrative dhe ndihmë për përktim të datës 10.12.2012, drejtuar gjyqtarit kryesues të Dhomës së Posaçme;*
- *Deklaratën për mjetet financiare me të dhënat e paditësit;*

Më 11 dhjetor 2012 Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës pranon një parashtrësë nga paditësi N.I., rruga nr. 93 në Prizren, përmes së cilës e njofton gjykatën se tani e tutje në këtë lëndë mbetet i vetëm pasi që nuk ka mirëkuptim për bashkëveprim të mëtejshëm me ta.

Gjykata Komunale në Prizren me aktvendimin C. nr. 588/95 të datës 16.12.2011 shpallet inkompetente në pikëpamje lëndore dhe shkresat e kësaj lënde i dërgon në Dhomën e Posaçme si gjykatë kompetente.

Më 23 shkurt 2012 Dhoma e Posaçme ka pranuar shkresat e lëndës pas plotfuqishmërisë së aktvendimit C. nr. 588/95 të datës 16.12.2011, nga Gjykata Komunale në Prizren.

Në shkresa të lëndës gjykata gjen këto prova:

- *Padinë e dorëzuar më 7 korrik 1995 në Gjykatën Komunale në Prizren;*
- *Disa fletëdërgesa për dorëzim personal të paditësve në data të ndryshme;*
- *Shkresa me nr. 2259 e datës 9 korrik 1996 e dorëzuar paditësit në Gjykatën Komunale të Prizrenit lidhur me kompletimin e dokumentacionit;*
- *Procesverbal i datës 10 korrik 1996 për lëndën me nr. 588/95 përmes së cilit seanca përgatitore e asaj date shtyhet për datën 2 shtator 1996;*
- *Procesverbal i datës 2 shtator 1996 për lëndën me nr. 588/95 përmes së cilit seanca e asaj date shtyhet;*
- *Shkresa e datës 2 shtator 1996 e lëshuar nga gjyqtari i Gjykatës Komunale në Prizren drejtuar NSH që brenda afatit prej 5 ditëve nga pranimi i kësaj shkrese të dorëzojnë vendimin e datës 24.05.1995 përmes së cilit paditësve iu ishte ndërprerë marrëdhënia e punës;*
- *Përgjigja e NSH me nr. 2352 të datës 9 shtator 1996 ndaj urdhrin të Gjykatës në të cilin ceket dorëzimi i vendimit të kërkuar nga gjykata.*

Më 26 shkurt 2019 Agjencia Kosovare e Privatizimit dorëzon në Dhomën e Posaçme mbrojtjen e saj në të cilën thekson se padia është parashtruar në kundërshtim me Nenin 10 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 për AKP-në sepse ndaj NTSH Prizren ka filluar procedura e likuidimit me vendimin e Bordit të AKP-së nga data 11 qershor 2013.

AKP-ja në mbrojtjen e saj kërkon nga Dhoma e Posaçme që të hedhë poshtë padinë e paditësve ose të refuzohet si e pabazuar.

Më 15 mars 2019 Paditësi N.I. paraqet përgjigjen e tij në Dhomën e Posaçme kundër mbrojtjes së AKP-së.

Në përgjigjen e tij pohon se në vitin 1995 kishte parashtruar padi në Gjykatën Komunale në Prizren për anulimin e vendimit lidhur me shpalljen si tepriçë teknologjike.

Paditësi në përgjigje thekson se pushteti i atëhershëm në baza të diskriminimit në vitin 1995 e ka larguar atë dhe ka pranuar punëtorë tjerë të përkatësisë serbe.

Paditësi konsideron se është larguar nga puna në mënyrë kundërligjore dhe të njëjtit i takojnë të gjitha të drejtat bazuar në Kushtetutë, ligjet pozitive dhe Kartën Sociale Evropiane.

Si rrjedhojë, paditësi kërkon nga Gjykata që padia e tij të aprovohet si e bazuar në ligj.

Zyra e Regjistratit këtë lëndë e regjistron me numrin C-II.-13-0146-C0001.

Për detaje tjera referimi bëhet tek dosja e lëndës.

Arsyetimi ligjor:

Vendimi lëshohet pa mbajtur seancë dëgjimore sepse faktet dhe provat e deponuara në lëndë janë mjaft të qarta, andaj gjyqtari individual nuk pret që në seancë të ketë më tepër informacione dhe argumente në kuptim të nenit 72 paragrafi 11 të Ligjit të DHPGJSK (Nr. 06 L-086).

NSH-JA ËSHTË NË PROCES TË LIKUIDIMIT.

Pasi që as Dhoma e Posaçme e as Agjencia nuk e lejuan vazhdimin e veprimit të pezulluar, lënda në fjalë pezullohet.

Neni 22, paragrafi 2.6 i Ligjit nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme parasheh që: *‘kur ekzistojnë rrethana detyruese që arsyetojnë veprimin e tillë: pezullon lëndën apo procedurën apo zbatimin e një aktvendimi apo aktgjykimi, ose në përgjithësi, apo deri në një kohë apo ngjarje të caktuar’.*

Gjithashtu, Neni 10, paragrafi 1 i Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 për AKP-në parasheh që: *‘Çdo veprim gjyqësor, administrativ apo i arbitrazhit, procedurë apo akt që përfshin apo që është kundër një ndërmarrje (apo asetëve të saj) që është subjekt i Vendimit për Likuidim pezullohet pas parashtrimit të njoftimit të Vendimit për Likuidim nga ana e Autoritetit të Likuidimit në gjykatën përkatëse, autoritetin publik apo tribunalin e arbitrazhit’.*

Paditësi i lartpërmendur është dashtë t’i drejtohej Komisionit të Likuidimit të Ndërmarrjes Shoqërore , në Prizren, dhe ta dorëzonte kërkesën tek ai organ, pasi që Komisioni i Likuidimit të NSH-së është i vetmi entitet që ka të drejtë të kontrollojë, të trajtojë dhe t’iu përgjigjet padive/kërkesave në të cilat NSH-ja në likuidim thirret si e paditur.

Prandaj, u vendos si dispozitiviv të këtij aktvendimi.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditësh nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 paragrafi 6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Teuta Ibrahim – Gjyqtare _____